



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika-Odeljene za
Politike Pravosudnog Sistema, Slobodne Profesije I Statistiku- Department of Justice Sytem
Policies, Freelance Professions and Statistics

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPSDPLS.nr.06/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.977/23, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija Kërveshi, pala ankuese me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga nga Prishtina, Përmbaruesi Privat dhe përfaqësuesit i tij , me datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika , DPSDPLS. 06/2025 i datës 04.04.2025, si dhe ankesa e palës ankuese me seli në Prishtinë, e datës 03.04.2025 **si të pabazuara.**

II. Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore, P.nr.977/23.

A r s y e t i m

Pala ankuese, me seli në Prishtinë, me datën 03.04.2025 ka parashtruar ankese ndaj përmbaruesit privat. Sipas ankesës, përmbaruesi, me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore ka vazhduar ekzekutimin e mjeteve financiare nga xhirollogaritë e bllokuara bankare të , në shumën prej 5,814,196.29 euro edhe përkundër deklarimeve dhe kërkesave të , për mos vazhdimin e ekzekutimit të mjeteve, përkundër faktit se të njëjtit i ishte sqaruar se procedura. përmbarimore ishte kthyer në rigjykim sa i përket borxhit të

shkelje të detyrës dhe tejkalim të kompetencave dhe autorizimeve të besuara me ligj, duke konsumuar në tërësi, bashkarisht dhe veç e veç, shkelje disiplinore të përcaktuara e të specifikuara në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.10 të LPP-së, duke kërkuar që përmbaruesit t'i shqiptohet masat disiplinore sipas nenit 368, paragrafi 1.5 i LPP-së "shkarkim nga detyra", ndërsa nga Ministria e Drejtësisë ka kërkuar që derisa zgjatë procedura disiplinore, në mbështetje të nenit 368.2 të LPP-së, të njëjtin të suspendojë nga detyra.

Përmbaruesi privat në përgjigjen e tij ka deklaruar se si Përmbarues Privat ka përfunduar me Vendim me datë 30.05.2024, lëndën të cilën komisioni Ad hoc i Ministrisë së Drejtësisë ia ka ngarkuar me punë, pasi që kësaj lënde i ishte dhënë Urdhëri për rimbartim nga kolegu i

të cilit i ishte marrë licenca, duke u bazuar në Aktvendimin KPPP.Nr.2074/2023, të datës 16.02.2024. Duke e ditur që për të njëjtën çështje janë suspenduar nga puna dy përmbarues dhe atë (hih Vendimin DPL.nr.32/22, datë 30.12.2022) dhe ky personalisht nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, për të dyja rastet, është vërtetuar se nuk ka patur asnjë shkelje në procedurë dhe se padrejtësisht është suspenduar pa asnjë bazë ligjore, (shih Vendimin DPL.nr.05/24, datë 15.05.2024), por duke u bazuar në thënje të pabazuara dhe të manipuluar të debitorit dhe duke e kënaqur egon personale në dëm të Përmbaruesit dhe të sigurisë ligjore. Kjo çështje është stërholluar deri në atë pike, sa që ka patur edhe reagime nga Unioni Ndërkombëtar i Përmbaruesve.

Që të jetë më e qartë, përmbaruesi në vazhdim ka shtuar se këtu nuk bëhet fjalë për tërheqje përtej shumës së kompenzimit gjatë punës së tyre si Përmbarues, pasi të njëjtët mbështeten edhe te Aktvendimi, KPPP.Nr.2074/23 i datës 15.03.2024, me të cilin është refuzuar ankesa për parregullsi e debitorit e datës 08.03.2024. Sipas aktvendimit, gjykata ndër të tjera kishte refuzuar edhe sa i përket shpenzimeve të procedurës në të cilin rast gjykata ka trajtuar dhe sqaruar (shiqo faqen 5 të Aktvendimit) se inkasimi i shpenzimeve përbën inkasim të ligjshëm dhe është në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ. Andaj, ky pretendim paraqet çështje të gjykuar, e për më tepër tani që është ripërsëritur, është i pabazuar. Debitori

(në rastin e lëndës Pnr.977/23), ka paraqitur Propozim për Kundërpërmbartim, ku Gjykata Themelore në Prishtinë- dega në Fushë Kosovë, me Vendimin, CP.nr.55/24, të datë 14.03.2025, aprovoi, propozimin dhe caktoi kundërpërmbartimin, ashtu që detyroi kreditorin Dardafon LLC, t'ia kthej shumën e diferencës, mirëpo askund nuk ceket që përmbaruesi ka bërë shkelje për tejkalimin e inkasimit të shpenzimeve të procedurës në këtë lëndë. Lënda është proceduar dhe ka përfunduar sipas Aktvendimit, KPPP.Nr.2074/2023, të datës 16.02.2024.

Më tutje ka theksuar se ky si Përmbarues Privat, lëndën e ka përfunduar me Vendim, me datë 30.05.2024, ku deri me këtë datë, i njëjti, nuk ka pranuar vendim tjetër nga ana e Gjykatës, se lëndën e ka kryer me përpikëri sipas Vendimit në fuqi dhe se nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore. Ka kërkuar nga Komisioni që të hudh posht raportin për fillimin e procedurës disiplinore si të pabazuar, të gjykuar, të përsëritur dhe lejuar kundërpërmbartimin sipas Aktvendimit CP.nr.55/24, të datë 14.03.2025, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë- dega Fushë Kosovë.

Në seancën e mbajtur, pala ankuese ka kërkuar nga komisioni disiplinor që lidhur me këtë çështje përmbaruesit privat ti shqiptohet masa disiplinore sipas propozimit të paraqitur me datë 03.04.2025 si dhe të obligohet i njëjti që këto mjete ti kthejë, pasi që është parim themelor i drejtësisë që të ruhet parimi i ekonomizimit të procedurës të palëve në procedurë dhe palët përderisa kanë mundësi, të mos përfshihen në procedura të panevojshme. Mjetet e tilla meqenëse janë tërhequr pa bazë ligjore, duhet të përllogariten me kamatën e përcaktuar ligjore prej 8%.

Sipas përmbarduesit, pas përmbjlljes së procedurës përmbardimore zyrtarët e përmbes emailave kanë ushtruar ndikim te organi përmbardimor që të ndryshoi veprimet e tij të cilat kanë qenë konform vendimit të gjykatës duke konsideruar kinse përmbarduesi ka marrë shitesë jashtë këtyre aktvendimeve, mirëpo përmbarduesi privat përmbes këtyre emailave jo vetëm që ka qenë i përgjegjshëm, por ka dhënë rekomandime se si duhet vepruar duke iu referuar nenit 54 të LPP-së Pra përmbarduesi sipas të autorizuarit të tij , i ka udhëzuar palët që në rast se konsiderojnë që përmbarduesi ka inkasuar mjete më tepër , ata udhëzohen që në procedurën e kundërpërmbardimit, sipas të njëjtit nen, pra nenit 54, paragrafi 1.3 të ceket se gjatë kryerjes së procedurave përmbarduese, kreditori ka marrë më shumë se sa vlera e kredisë përfshirë kostot e përmbardimit dhe kamatës, Kështu pala në kërkesën drejtuar gjykatës , përpos pjesës së zvogëluar, ka kërkuar kamatën dhe nuk ka kërkuar koston e përmbardimit e cila është e specifikuar ligjërisht, Prandaj, si rrjedhojë, Përmbarduesi privat në asnjë mënyrë, nuk mund ti kthej këto shpenzime përmbardimore-kosto pasi që do të kishte shkelur po këtë ligj, nenin 54 dhe mbetet në vullnetin e palës që të kërkoj apo mos të kërkoj këtë për më shumë profesionistët ligjor të këtu debitorit, kanë bërë edhe dëme ndaj kompanisë telekom, pasi që në procedurën e kundërpërmbardimit, nuk e kanë kërkuar koston e përmbardimit, edhe pse ligji ua njeh këtë të drejtë.

Komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë me të cilën do provohej që përmbarduesi privat ka bërë tejkalim të autorizimeve apo ndonjë shkelje sipas pretendimeve në ankesë dhe nuk ka mundur të vërtetohet me provat e ofruara ndonjë shkelje ligjore. Komisioni ka analizuar provat e ofruara, dhe ka pasur parasysh edhe deklarin e palës ankuese por dhe veprimet e përmbarduesit, pasi shuma e inkasuar dhe përmbjllja e rastit është kryer para se gjykata të vendos për ulje të shumës së obligimit dhe për shumën e përfunduar në përmbardim, është bërë edhe inkasimi i shpërblimit të tarifave përmbardimore.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARDUESIT PRIVAT

DPSDPLS.nr.6/2025 datë 12.06.2025

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.